



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.24

23 mars

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.190, datë 9.3.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.1065, datë 29.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetrat”.....	863
Vendim i GJK nr.5, datë 2.3.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.42, datë 15.1.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	864
Vendim i GJK nr.6, datë 7.3.2011	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.305, datë 28.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.....	868
Vendim i GJK nr.7, datë 7.3.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.00-2009-674, datë 26.6.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	873

VENDIM
Nr.190, datë 9.3.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1065, DATË 29.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT NGA
TAKSA E BIZNESIT TË VOGËL TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE
TAKSIMETRAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1065, datë 29.12.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kopjen e kontratës me një nga “Shoqëritë e autorizuar” nga Ministri i Financave, për ofrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale në rastin e pajisjeve fiskale.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1. Në rastet kur tatimpaguesi ka blerë pajisjen fiskale nga “Shoqëria e autorizuar”, Bashkimi i Operatorëve PKP & Rilindja, sh.p.k., për blerjet deri në datën 26.7.2010, datë në të cilën kësaj kompanie i është hequr autorizimi nga Ministria e Financave, tatimpaguesi duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, dokumentacionin e paraqitur në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, përmendur më lart, të këtij vendimi.

2.2. Tatimpaguesi, që ushtron veprimtari në ofrimin e shërbimit të taksisë, duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, brenda datës 31 mars 2011, formularin e rimbursimit të pagesës për taksimetrin, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e faturës së blerjes së taksimitrit.

b) Kopjen e kontratës me shoqërinë shitëse të taksimtrave (nëse disponohet).

c) Kopjen e njoftim - vlerësimit tatimor për vitin ushtrimor, të lëshuar nga zyra e taksave të bashkisë ose të komunës.

ç) Faturën e plumblosjes që vendoset nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.”.

3. Fjalja e fundit e pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Procedura e këtij rimbursimi është e njëjtë, si në rastin e rimbursimit për pajisjet fiskale, të përcaktuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.5, datë 2.3.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 28.10.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 22/7 Akti që i përket:

KËRKUES: Ardian Çukaj, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, e përfaqësuar nga prokurori Kujtim Luli, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.42, datë 15.1.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Sadushi; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin nr.3, datë 18.1.2005, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Ardian Çukaj, për veprën penale të “trafikimit të femrave për prostitucion” në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 114/b-2 të Kodit Penal, si dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, pas ankimit të bërë nga mbrojtësi i kërkuesit, i caktuar nga familja, me vendimin nr.22, datë 24.5.2005, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.3, datë 18.1.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda”.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i investuar me rekurs nga avokati i të gjykuarit Ardian Çukaj, me vendimin nr.210, datë 12.4.2006, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit”.

Vendimi nr.3, datë 18.1.2005 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është vënë në ekzekutim në datën 11.9.2009, pas ekstradimit të të dënuarit Ardian Çukaj nga autoritetet italiane.

Në datë 16.9.2009, shtetasi Ardian Çukaj ka dorëzuar një kërkesë përpara Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr.3, datë 18.1.2005 të kësaj gjykate, duke paraqitur si shkak faktin se gjykimi në shkallë të parë është bërë në mungesë të tij, pa pasur asnjë dijeni mbi procedimin dhe se ankimi në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda është bërë nga një mbrojtës i caktuar pa dijeninë e tij.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr.51, datë 20.10.2009, vendosi: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Ardian Çukaj me objekt rivendosje në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr.3, datë 18.1.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si të pabazuar në ligj”.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, pas ankimit të bërë nga mbrojtësi i kërkuesit, me vendimin nr.33, datë 17.11.2009, vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit nr.51, datë 20.10.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda”.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas rekursit të ushtruar nga avokati i kërkuesit, me vendimin nr.42, datë 15.1.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit Ardian Çukaj ndaj vendimit nr.51, datë 20.10.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe vendimit nr.33, datë 17.11.2009 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me arsyetimin se “*Rekursi i paraqitur nga kërkuesi Ardian Çukaj nëpërmjet përfaqësuesit avokat Saimir Vishaj nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit, siç parashikon neni 135/2 i Kodit të Procedurës Penale dhe as nënshkrimin e vetë kërkuesit Ardian Çukaj; nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale*”.

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) përmes avokatit të tij, pretendon:

Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit kërkuesit i është refuzuar kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr.3, datë 18.1.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, është marrë në shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të mohimit të së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës.

Sipas pretendimit të kërkuesit, përmes mbrojtësit të tij, është paraqitur recurs kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit për Krime të Rënda pranë sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda. Recursi, sipas tij, është paraqitur në 3 (tri) kopje, ku njëra prej tyre (eventualisht) ka qenë e panënshkruar. Pikërisht kjo kopje është dërguar nga sekretaria në fjalë në Gjykatën e Lartë dhe, si rrjedhojë, kjo e fundit ka vendosur mospranimin e kërkesës për arsyen e mësipërme.

Subjekti i interesuar, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare këto prapësime:

- Pretendimet e kërkuesit nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, pasi paraqitja e një rekursi të panënshkruar në Gjykatën e Lartë nuk mund të konsiderohet si shterim i të gjitha mundësive ligjore për t’u ankuar kundër vendimeve gjyqësore të kundërshtuara. Ankimet që nuk respektojnë afatin e paraqitjes ose që nuk janë të nënshkruara rregullisht, siç kërkon ligji procedural, në aspekt të pasojave juridike që prodhon kjo parregullsi, duhen konsideruar si raste të mosushtrimit të mjetit përkatës të ankimit.

- Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës së Lartë, si rezultat i mungesës së nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, është i pabazuar pasi kjo është kërkesë ligjore e nenit 435, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale.

- Kërkuesi nuk ka ngritur pretendime për kushtetutshmërinë e nenit 435, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale dhe, për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese nuk mund të zgjerojë kryesisht objektin e gjykimit.

II

1. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi ka pretenduar se, për shkak të një gabimi ose pakujdesie të karakterit administrativ nga ana e sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, atij i është mohuar padrejtësisht, për arsye procedurale të pavarura prej tij, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës.

Kjo e drejtë parashikohet nga neni 42 i Kushtetutës, i cili thekson:

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”;

si dhe nga neni 6, paragrafi 1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), sipas të cilit:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë ... e cila do të vendosë ... për ... bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij.”

Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka trajtuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo e drejtë e individit përbën garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ -së (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009*).

Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7.2006*).

E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve, por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*).

Edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) në jurisprudencën e saj është shprehur se fakti që aplikanti ishte në gjendje të paraqiste çështjen e tij përpara një gjykate, nuk përmbush domosdoshmërisht në vetvete kërkesat e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Rregullat, të cilët dispijlojnë hapat formalë që duhen ndërmarrë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Nga ana tjetër, është kërkesë e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, që mospranimi i një ankimi në Gjykatën e Lartë të mos cenojë thelbin e të drejtës së ankimesit për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet e GjEDNJ-së në çështjet Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997, Saez Maeso kundër Spanjës, datë 09.11.2004*). Në çështjen *Delcourt kundër Belgjikës*, të datës 17.1.1970, GjEDNJ shprehet: “Vendimet gjyqësore gjithmonë ndikojnë mbi personat. Megjithëse vendimi i Gjykatës së Kasacionit thjesht konfirmon ose anulon një vendim, ai vendim mund të ketë efekte të ndryshme në pozicionin e personit të interesuar. Madje, nganjëherë, gjykimi i Kasacionit ka pasoja shumë më të mëdha mbi fatin e një personi se vendimet e gjykatës së faktit dhe të apelit. Është e vërtetë që neni 6 § 1 nuk kërkon nga shtetet themelimin e gjykatës së apelit ose të kasacionit. Megjithatë, një shtet i cili i ka këto gjykata, është i detyruar të sigurojë se personat që i drejtohen ligjit do të gëzojnë përpara këtyre gjykatave garancitë themelore të parashtruara në nenin 6 të KEDNJ. Në një shoqëri demokratike në kuptimin e kësaj Konvente, e drejta për një administrim të mirë të drejtësisë zë një vend kaq të dallueshëm, saqë asnjë interpretim i ngushtë i nenit 6 § 1 nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e kësaj dispozite”.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka vërejtur se në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, neni 435/2 i Kodit të Procedurës Penale nuk mund të interpretohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një mënyrë të tillë të ngushtë, që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Mbrojtja me avokat e të pandehurit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenin 437, pikat 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale, është vlerësuar nga Gjykata si kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë.

Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se edhe neni 435/2 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhen të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar

mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikojnë rregullat procedurale penale. Qëllimin e ligjvënësist, për të garantuar mbrojtës në këtë proces, e shpreh edhe detyrimi që kjo normë i ngarkon kryetarit të kolegjit, për të caktuar një mbrojtës kryesisht për të pandehurin, i cili nuk ka mbrojtës të zgjedhur.

Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinonjë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 e Kodit të Procedurës Penale, si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të Kodit të Procedurës Penale). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale. Një interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2, nuk i shërben rritjes së standardit në favor të garancive për të mos humbur të drejtën e gjykimit, përkundrazi sjell si pasojë cenimin e të drejtës së të pandehurit për akses në Gjykatën e Lartë (*shiko vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin në shqyrtim, nga analiza e materialeve shkresore që gjenden në dosjen gjyqësore në emër të kërkuesit, rezulton që kopje të rekursit, të depozituara pranë gjykatës janë të nënshkruara dhe vulosura nga mbrojtësi i kërkuesit, avokat Saimir Vishaj. Ky element procedural është vërtetuar nga shkresa nr 24/6 prot., datë 24.06.2010, që Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i ka dërguar Gjykatës. Pra, rekursi i dorëzuar prej kërkuesit (së paku një kopje e tij), ka qenë konform rregullimit të parashikuar nga neni 435 i Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, po në dosje, figuron edhe një tjetër kopje e rekursit, pikërisht ajo që është dërguar nga sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për në Gjykatën e Lartë, e cila nuk mbart mbi vete as vulën dhe as nënshkrimin e mbrojtësit. Në vijim, mungesa e nënshkrimit renditet edhe si shkak i parë i mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë.

Gjykata, në një çështje pothuajse të ngjashme me këtë në shqyrtim, ka arritur në përfundimin se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shiko vendimin nr.22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, përpara se të vendosë mospranimit të rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë dhënë nenit 415/2 të Kodit të Procedurës Penale, në vendimin unifikues nr. 5, datë 15.09.2009, kur shprehen: “Sekretaritë e gjykatave ku depozitohet ankimi mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të Kodit të Procedurës Penale, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij”. Gjithashtu, në rastin kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të tij, duhet verifikuar nëse kryetari i kolegjit e ka përmbushur detyrimin e tij për të caktuar avokat kryesisht. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Kushtetuese, në frymën edhe të jurisprudencës së GjEDNj-së, tërheq vëmendjen se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive.

2. Gjykata vëren, gjithashtu, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij të ankimuar nga kërkuesi shkon përtej konstatimit të mangësisë procedurale të rekursit, kur thekson se “[rekursi] nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale”.

Në vlerësimin e Gjykatës, ky konkluzion, që ka të bëjë me thelbin e pretendimeve të kërkuesit, është kontradiktor dhe jologjik, në kuptim të vijimësisë strukturale të vendimit. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të

drejtë juridik. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 9.3.2009; nr.23, datë 23.7.2009 dhe nr.38, datë 30.12.2010*). Në rastin në shqyrtim, Gjykata thekson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej dhe nuk mund të vijonte me arsyetime që kishin të bënin me thelbin e së drejtës, ndërkohë që kishte vërejtur mosrespektimin e kërkesës procedurale për mos nënshkrimin e mbrojtësit që e bënte rekursin *ultra vires*.

Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kërkuetit Ardian Çukaj i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizohet, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, vendimi nr.42, datë 15.1.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- I dërgohet çështja për rishqyrtim Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Sadushi, Sokol Berberi.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Petrit Ploçi, Altina Xhoxhaj.

VENDIM

Nr.6, datë 7.3.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 12.10.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17/3 Akti që i përket:

KËRKUES: Veiz Abazi

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Zyra e shërbimit përmbartimor Mat, në mungesë.
2. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Mat, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.305, datë 28.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj; kërkuesin, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.4, datë 5.1.1991 të Këshillit Popullor (KP) të Qytetit të Burrelit, kërkuesit Veiz Abazi i është miratuar leja për ndërtimin e një shtëpie në një zonë pranë stadiumit të qytetit. Duke qenë se kërkuesi nuk ka mundur të ndërtojë në këtë zonë, për shkak të mosmarrëveshjeve me ish-pronarët e truallit, ai ka ndërtuar, bazuar në vendimin e mësipërm të KP-së, në një truall pranë shkollës 8-vjeçare të qytetit.

Në vitin 1993 kërkuesi i është drejtuar me kërkesë zyrës së hipotekës Mat për regjistrimin e kësaj pasurie. Kjo zyrë, me plotësimin e dokumentacionit nga ana e kërkuesit, ka kryer regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrin hipotekor me nr.105 regjistri, datë 31.12.1993, që figuron dhe si regjistrimi fillestar i kësaj pasurie.

Pas vitit 1994, me hedhjen e të gjitha regjistrimeve të pasurive në sistemin përkatës, zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP) Mat ka kryer edhe regjistrimin e pasurisë së kërkuesit dhe ai është pajisur me një vërtetim të ri hipotekor me nr.105 regjistri, nr.pasurie 6/78, zona kadastrale 1326, vol.16, faqe 86.

Në vitin 2001 kërkuesi ka dashur të shesë pasurinë e tij dhe për këtë qëllim i është drejtuar ZRPP-së Mat për t'u pajisur me vërtetimin e kësaj pasurie për efekt shitjeje. Me pretendimin se dokumentet në dosjen e regjistrimit nuk janë të plota, pasi mungon leja e ndërtimit origjinale dhe planvendosja, kërkuesit nuk i është lëshuar vërtetimi i pronësisë.

Në këto rrethana kërkuesi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, e cila, përfundimisht, me vendimin nr.305, datë 28.6.2007, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar ZRPP-në Mat të lëshojë vërtetimin e pronësisë për efekt shitjeje të pasurisë së kërkuesit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Me vendimin nr.41, datë 7.9.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin nr.305, datë 28.6.2007.

Në datën 11.9.2007, pranë zyrës së përbarimit Mat është regjistruar dosja përbarimore me kreditor kërkuesin.

Me shkresën nr.196-17, datë 11.9.2007, zyra e përbarimit Mat i ka dërguar ZRPP-së Mat lajmërim për ekzekutimin vullnetar të vendimit nr.305, datë 28.06.2007.

Me urdhrin nr.642, datë 20.9.2007, Zyra e Përbarimit Mat ka urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit nr.305, datë 28.6.2007.

Me vendimin nr.746, datë 9.10.2007 të Zyrës së Përbarimit Mat, regjistruesi i ZRPP-së Mat është gjobitur me 50 000 lekë gjobë për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës.

Meqënëse nga ana e regjistruesit është refuzuar përsëri ekzekutimi i titullit ekzekutiv, me pretendimin se dokumentacioni i titullit të pronësisë së kërkuesit Veiz Abazi është i parregullt dhe i pambështetur në ligj, zyra e përbarimit ka bërë ndaj tij kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Mat, për kryerjen e veprës penale të pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal.

Megjithatë, edhe pas kryerjes së këtyre veprimeve nga zyra e përbarimit, kjo e fundit nuk ka mundur të ekzekutojë urdhrin e ekzekutimit nr.41, datë 7.9.2007.

Me kërkesën datë 6.4.2010, *kërkuesi Veiz Abazi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar prej saj të konstatojë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e

mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.305, datë 28.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së kërkuarit, duke u detyruar ZRPP-ja Mat të lëshojë vërtetimin e pronësisë për efekt shitjeje të pasurisë së tij.

Subjekti i interesuar, ZRPP-ja Mat, ka paraqitur parashtrime me shkrim përpara Gjykatës, në të cilat pretendon:

- Regjistrimi i kërkuarit ka mungesa në dokumentacion dhe për pajisjen me vërtetim pronësie ai duhet të aplikojë pranë ZRPP-së Mat për regjistrimin e titullit të pronësisë që pretendon.

- Dokumentacioni, me anë të të cilit është kryer regjistrimi, përbëhet nga vendimi nr.4/1991 i KP-së rrethit Burrel, planimetria dhe preventivi i banesës, në një kohë kur në pasurinë e lartpërmendur mungon dokumentacioni ligjor që vërteton marrëdhëniet me truallin, si dhe mungon planvendosja që shoqëron vendimin për leje ndërtimi (kërkesa këto që e bëjnë titullin e pronësisë të regjistrueshëm).

- Pasuritë e zonës kadastrale 1326 të qytetit të Burrelit janë afishuar pranë ZRPP-së Mat nga data 14.9.2006 – 14.12.2006, por nga ky shtetas nuk ka patur interesim për sqarimin e gjendjes juridike të pronës së pretenduar prej tij.

- Seksioni i urbanistikës pranë bashkisë Burrel ka bërë me dije se kjo pasuri është në kundërshtim me planin rregullues të qytetit, pasi Veiz Abazi e ka ndërtuar banesën e tij në territorin sportiv të shkollës “Ilia Qiqi”, por pa u pajisur më parë me leje sheshi dhe pa leje ndërtimi.

- ZRPP-ja Mat, bazuar në urdhrin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), nuk mund të lëshojë vërtetim pronësie për pasuritë që nuk janë futur në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

- Kërkuari Veiz Abazi, përpara se të kërkojë pajisjen me vërtetim pronësie, duhet të aplikojë pranë ZRPP-së Mat për regjistrimin e titullit të pronësisë që ai posedon dhe pas këtij aplikimi kjo zyrë do të veprojë sipas rregullimeve ligjore përkatëse.

II

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

Gjykata ka theksuar se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.6 datë 31.3.2006; nr.9, datë 1.4.2009; nr.21, datë 21.7.2009; nr.8, datë 23.3.2010; nr.35, datë 27.10.2010*). Parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të përcaktuara në nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 2.4.2003; nr.11, datë 10.3.2003; nr.8, datë 23.3.2010*).

Gjykata ka pranuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.12.2007; nr.6, datë 04.3.2010; nr.35, datë 27.10.2010*).

GJEDNJ-ja ka theksuar se parimet lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, janë të një rëndësie akoma më të madhe në kontekstin e procedurave administrative që kanë të bëjnë me një mosmarrëveshje, rezultati i së cilës është vendimtar për të drejtat

civile të kërkuarit. Mbrojtja efektive e një pale në procedura të tilla dhe rikthimi i ligjshmërisë nënkupton një detyrim për autoritetet administrative të zbatojnë vendimet e gjykatës. Në lidhje me këtë Gjykata vëren se autoritetet administrative përbëjnë një element të shtetit të së drejtës dhe, si pasojë, interesat e tyre përputhen me nevojat për administrimin e mirë të drejtësisë. Nëse autoritetet administrative refuzojnë ose nuk zbatojnë këto vendime, ose thjesht vonojnë ta bëjnë këtë, garancitë e nenit 6, që gëzojnë palët gjatë fazës së gjykimit, e humbasin qëllimin e tyre (*shih vendimet e GJEDNJ-së datë 19.3.1997 në çështjen Hornsby v. Greece (I)*), § 41; datë 27.5.2004, në çështjen *Metaxas v. Greece*).

Gjykata, mbështetur në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuarit dhe sjelljen e autoriteteve publike. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore.

Në lidhje me sjelljen (veprimet) e kërkuarit, rezulton se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës të cenuar. Kërkuari rezulton t'i jetë drejtuar disa herë si ZRPP-së Mat, me kërkesë për regjistrimin e pasurisë së tij, bashkisë Burrel, si dhe institucioneve të Avokatit të Popullit, Presidentit të Republikës, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, ZQRPP-së etj. Pasi është pajisur me një vendim të formës së prerë të gjykatës, të ekzekutueshëm, në favor të tij, ai i është drejtuar zyrës së përbarimit Mat për të siguruar ekzekutimin e këtij vendimi.

Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, rezulton se zyra e përbarimit Mat ka kryer të gjitha veprimet që i lejon ligji, për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë të gjykatës. Fillimisht, në datë 11.9.2007, në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka kërkuar ekzekutimin vullnetar dhe më pas, në datë 20.09.2007, ka urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të gjykatës. Duke qenë se nuk ka arritur ekzekutimin e këtij vendimi, në datë 9.10.2007, ka zbatuar sanksione ndaj debitorit (regjistruesi i ZRPP-së Mat), bazuar në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile. Meqënëse nga ana e debitorit përsëri është refuzuar ekzekutimi i titullit ekzekutiv, në datë 18.12.2007 është bërë kallzim penal kundër këtij funksionari, pranë Prokurorisë së Rrethit Mat, për kryerjen e veprës penale të pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Kjo zyrë, edhe pse ka ndjekur procedurën ligjore, nuk ka mundur të ekzekutojë urdhrin e ekzekutimit nr.41, datë 7.9.2007.

Përsa i përket periudhës që duhet marrë në konsideratë, rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat nr.305, datë 28.6.2007 ka marrë formë të prerë më 24.7.2007, kurse në datë 7.9.2007 është lëshuar urdhri i ekzekutimit të këtij vendimi (vendimi nr.41 i po kësaj gjykate). Në datë 11.9.2007 zyra e përbarimit Mat ka filluar veprimet përbarimore për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës. Kjo periudhë fillon në momentin e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit (2007) dhe, duke qenë se pas tre vjetësh ky vendim nuk është ekzekutuar ende, si dhe duke patur parasysh objektin e ekzekutimit, ajo duhet konsideruar relativisht e gjatë.

Përsa i përket sjelljes së debitorit, ZRPP-së Mat, nga kjo e fundit pretendohet se regjistrimi i kërkuarit ka mungesa në dokumentacion dhe për pajisjen me vërtetim pronësie ai duhet të aplikojë pranë ZRPP-së për regjistrimin e titullit të pronësisë që pretendon, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës që përfshin dhe lejet përkatëse të ndërtimit. Për pajisjen me leje ndërtimi kërkuari duhet t'i drejtohet zyrës së urbanistikës pranë Bashkisë, ndërkohë që kjo e fundit nuk mund ta miratojë këtë leje, me pretendimin se ligjet për urbanistikën përcaktojnë qartë dhe prerë se asnjë organ nuk mund të miratojë shesh dhe leje ndërtimi në zona të përcaktuara në ligjin për urbanistikën, pra zona sportive, social-kulturore, të gjelbërta etj. dhe se të gjitha objektet në zonën ku ndodhet prona e kërkuarit ose në zona të ngjashme, janë ndërtime të kundërligjshme (sa më sipër rezulton edhe nga korrespondenca ndërmjet ZRPP-së Mat dhe zyrës së urbanistikës pranë bashkisë Burrel [shkresat nr.101 Prot., datë 17.2.1999; nr.145 Prot., datë 15.4.2002; nr.886/1 Prot., datë 10.12.2007], si dhe korrespondenca ndërmjet bashkisë Burrel dhe Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës, të vënë në lëvizje nga kërkuari [shkresa nr.591, datë 31.10.2001, shkresa nr.1025/3 Prot., datë 14.5.2008]).

Gjykata vëren, gjithashtu, se ZRPP-ja Mat, duke u nisur edhe nga shkresat e shumta që i janë drejtuar asaj, jo vetëm nga zyra e përbarimit, por edhe institucionet e tjera ku kërkuari ka paraqitur shqetësimet e tij, ka informuar dhe i është drejtuar ZQRPP-së, e cila në shkresat e saj nr.3296/1 Prot., datë 23.5.2008 dhe nr.3296/5 Prot., datë 13.11.2008, drejtuar edhe Zyrës së Përbarimit, shprehet: *“Ekzekutimi i vendimit të gjykatës nr.305 dhe vendimet e Zyrës Përbarimore Mat do të vinin në*

kundërshtim me legjislacionin mbi të cilin bazon veprimtarinë e saj ZRPP-ja, pasi veprimet e regjistruesit janë kryer në bazë dhe në zbatim të ligjit.”

Duke patur parasysh rrethanat e kësaj çështjeje dhe veprimet konkrete të institucioneve, për të cilat kanë lindur detyrime nga vendimi i formës së prerë të gjykatës, Gjykata vlerëson se veprimet e zyrës së përmbartimit kanë qenë në përputhje me ligjin. Kjo zyrë ka zbatuar edhe sanksione ligjore ndaj debitorit, por megjithatë nuk ka bërë të mundur realizimin e të drejtës së kërkuesit. Përsa i përket debitorit, ZRPP-ja Mat, ai vazhdon të refuzojë ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës për regjistrimin e pasurisë së kërkuesit në regjistrin e pasurive të paluajtshme, duke paraqitur si pengesë ligjore shkresat e dërguara nga zyra e urbanistikës. Edhe pse pretendimet e ngritura nga këto institucione janë të tilla, që duhet të zgjidhen në rrugë gjyqësore, nuk rezultojnë që ndonjëra nga këto subjekte të ketë ezauruar mjetet ligjore në dispozicion. Subjekti i interesuar, ZRPP-ja Mat, pretendon se vendimi nr.305, datë 28.06.2007 është marrë në mungesë të tij, por nuk rezultojnë që ta ketë ankimuar këtë vendim pas marrjes dijeni të tij. Me shkresën nr.3296/5 Prot., datë 13.11.2008, ZQRPP-ja rekomandon ZRPP-në Mat të bëjë kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, bazuar në rregullimet e Kodit të Procedurës Civile, si dhe të vlerësojë ligjshmërimin e regjistrimit të pasurisë 6/78, të regjistruar vol.16, faqe 86, që i përket shtetasit Veiz Abazi. Edhe pas këtij rekomandimi nuk rezultojnë që subjekti i interesuar ZRPP-ja Mat të ketë proceduar me kundërshtimin në gjykatë të këtyre veprimeve përmbartimore.

Gjykata vëren se bazuar në nenin 6 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (i ndryshuar) ky institucion, mes të tjerash, drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë, si dhe kryen drejtimin metodik të shërbimeve dhe të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Bazuar në nenin 13/c të “Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, institucion i varësisë së Ministrisë së Drejtësisë është edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Duke qenë se është detyrë funksionale e organit epror të monitorojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e organeve vartëse, duke marrë masat përkatëse që funksionimi i këtyre të fundit të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, mosushtrimi i këtyre tagrave, për të siguruar që të drejtat e shtetasve të gantantohen ose për të korrigjuar gabimet e organit vartës në bazë të ndërhyrjes vertikale, do të ravigjehet në një përgjegjësi të organit epror. Për këtë arsye Gjykata e gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së këtij organi për të siguruar që vendimi i gjykatës i formës së prerë të ekzekutohet.

Përsa më sipër, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, duke i lënë pa efekt këto garanci mbrojtëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.305, datë 28.6.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Pllaçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thana, Sokol Berberi

VENDIM
Nr.7, datë 7.3.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 12.10.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24/9 Akti që i përket:

KËRKUES: Shefqet Zeneli, përfaqësuar nga avokati Dervish Selimi, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Anastas Lefta, Donika Lefta, Kostandin Lefta, përfaqësuar nga Konstandin Lefta, me prokurë të posaçme.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), qarku Berat, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.00-2009-674, datë 26.6.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/“f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj; kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës; subjektet e interesuara Lefta që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.4, datë 11.2.1992 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qytetit të Beratit, kërkuesit Shefqet Zeneli i është dhënë leje për ndërtimin e një dyqani në lagjen “10 Korriku”, të cilin e ka ndërtuar duke zënë sipërfaqen prej 110 m² dhe më pas ka vazhduar ndërtimin në të njëjtin vend, në një objekt tjetër, duke zënë një sipërfaqe prej 30m².

Me kontratën e shitblerjes nr.1761, datë 8.2.1995 kërkuesi ka blerë nga Seksioni i Financës i rrethit Berat sipërfaqen e truallit prej 140m² që zënë objektet e ndërtuara prej tij.

Me vendimin nr.186, datë 20.12.1994 të KKKP-së qarku Berat, subjekteve të interesuara Anastas Lefta, Donika Lefta dhe Kostandin Lefta u është njohur pronësia mbi një sipërfaqe truallit prej 1000m², nga e cila është kthyer 100 m² dhe pjesa tjetër është kompensuar. Kufitar me këtë pronë, në lindje, është lokali i kërkuesit Shefqet Zeneli.

Me vendimin nr.348, datë 23.2.1996 të KKKP-së, Qarku Berat, shtetasve Lefta u është njohur pronësia mbi një sipërfaqe tjetër truallit prej 2100 m², nga e cila është kthyer 356m² truall i lirë dhe pjesa tjetër është kompensuar.

Kërkuesi Shefqet Zeneli i është drejtuar gjykatës me padi për anulimin e vendimeve të mësipërme të KKKP-së dhe detyrimin e të paditurve Lefta ta njohin atë pronar mbi sipërfaqen e truallit prej 140m² truall.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr.1052, datë 30.12.2002, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.318, datë 4.7.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1957, datë 16.11.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr.318, datë 4.7.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.534, datë 4.11.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.1052, datë 30.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2007-851(732), datë 31.5.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.534, datë 4.11.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Kërkuesi Shefqet Zeneli i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr.00-2007-851(732), datë 31.5.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimit nr.534, datë 4.11.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr.1052, datë 30.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2009-674, datë 26.06.2009, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se kërkesa nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

Kërkuesi Shefqet Zeneli i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, pasi kjo gjykatë ka shkelur parimin e paanshmërisë në gjykim. Gjyqtari AM, i cili ka marrë pjesë në kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim, ka marrë pjesë edhe në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, në dhënien e vendimit nr.318, datë 4.7.2003.

- Kërkuesit i është mohuar e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë pasi, megjithëse ekzistonin kushtet e përcaktuara në nenin 494 të KPC-së, për rishikimin e vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e tij.

- Në datë 4.9.2007 u zbuluan dokumente në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit Tiranë, që vërtetojnë se prona që i është kthyer familjes Lefta me vendim të KKKP-së ka qenë pronë e Sami Vrionit dhe është blerë nga repartet e xhenios të ushtrisë italiane. Këto dokumente janë prova të reja në kuptim të nenit 294/a të KPC-së.

- Gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe kanë vepruar me njëanshmëri në drejtimin e procesit, marrjen e provave dhe fiksimin e tyre në procesverbalin e seancës.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat i ka mohuar kërkuesit të drejtën t'i bëjë pyetje dhe t'i kërkojë shpjegime ekspertit në lidhje me përcaktimin e kufirit lindor të pronës së të paditurve, shkelje që nuk u riparuan as në gjykimin në gjykatën e apelit.

Subjektet e interesuara Lefta, përfaqësuar me prokurë nga shtetasi Konstandin Lefta, parashetrojnë në argumentet e tyre para Gjykatës se:

- Gjytari AM, që ka marrë pjesë në gjykimin e kërkesës për rishikim, ka marrë pjesë më parë në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, por ky vendim u prish nga Gjykata e Lartë dhe çështja u kthye për rigjykim, me tjetër trup gjykues. Ishte ky vendim i fundit i gjykatës së apelit (ku gjyqtari AM nuk ishte pjesë) që la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të cilit i është referuar dhe ka shqyrtuar Gjykata e Lartë.

- Trupi gjykues, që kundërshton kërkuesi, në të vërtetë nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, por ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim, duke vlerësuar në përfundim se kërkesa dhe provat bashkëngjitur nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 494 të KPC-së.

- Vendimet e gjykatave janë të drejta dhe të bazuara në ligj, si vendimet që kanë zgjidhur në themel çështjen, ashtu dhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

II

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

Gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Gjykata ka theksuar, në jurisprudencën e saj, se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 13.4.2007; nr.21, datë 29.4.2010*).

Jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar “gjykatë e njëanshme” trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i pranishëm dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese 48, datë 30.7.1999; nr.1, datë 25.1.2010; nr.21, datë 29.4.2010*).

Në rastin në shqyrtim rezulton se një gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë në dy gjykime të iniciuara nga kërkuesi. Gjykata ka theksuar se një fakt i tillë nuk sjell a priori cenim të parimit të paanshmërisë, pasi çdokush mund të iniciojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme, por shprehet se i ndryshëm është qëndrimi kur i njëjti gjyqtar ose gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 29.4.2010*).

Rezulton se në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, ka qenë i pranishëm i njëjti gjyqtar që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së iniciuar nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në përfundim të gjykimit ka dhënë vendimin nr.318, datë 4.7.2003. Pra, i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe është shprehur për themelin e kësaj çështjeje (edhe pse ky vendim është prishur më pas nga Gjykata e Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim), ka marrë pjesë edhe në Kolegjin Civil që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim për të njëjtën çështje gjyqësore.

Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dy gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore dhe pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dy vendimet e dhëna për të njëjtat rrethana të pretenduara (ndërkohë që objektivistisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tij nga gjykimi) ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuesi, se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si i njëanshëm.

Përsa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivistisht e paanshme në perceptimin e publikut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

2. Lidhur me pretendimin se Kolegji Civil duhej të vendoste pranimin e kërkesës për rishikim

Kërkuesi Shefqet Zeneli pretendon se e drejta për një proces të rregullt ligjor është cenuar për arsye se, edhe pse ekzistonin kushtet e parashikuara në nenin 494 të KPC-së, Kolegji Civil vendosi mospranimin e kërkesës për rishikim në dhomë këshillimi.

Gjykata vëren se, bazuar në dispozitat e KPC-së, kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të

formës së prerë shqyrtohet nga Kolegji Civil, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Ky kolegji në dhomën e këshillimit verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkesit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe praninë e kritereve ligjore për shqyrtimin e saj. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 të Kodit ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, Kolegji vendos mospranimin e saj.

Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka konkluduar se një verifikim i tillë i kërkesës, nëse i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i dhomës së këshillimit, dhe jo i seancës gjyqësore. Gjykata ka theksuar se e gjithë kjo veprimtari seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Nga ana tjetër, përse i përket shqyrtimit paraprak mbi vetë rëndësinë e provës së re, Gjykata ka theksuar se ky gjykim është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon kjo Gjykatë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 25.2.2009*).

Përse më sipër, pretendimi i kërkesit për parregullsinë e procesit ligjor, për shkak të mospranimit të kërkesës për rishikim, është i papabuar.

3. Lidhur me pretendimet mbi vendimet e gjykatave që kanë shqyrtuar themelin e çështjes

Kërkesa e paraqitur para Gjykatës nga kërkuesi Shefqet Zeneli ka si objekt të saj shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, por nga kërkesa rezulton se kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për procesin e themelit, përse i përket zhvillimit të tij në të tri shkallët e gjyqimit.

Neni 30/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” ka parashikuar një afat dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës. Gjykata vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, mban datën 31.5.2007, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 13.4.2010. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesit në lidhje me vendimet e gjykatave që kanë shqyrtuar themelin e çështjes nuk mund të merren në shqyrtim, si të paraqitura jashtë afatit ligjor dyvjeçar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2009-674, datë 26.6.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

Jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për këto arsye:

Në arsyetimin e saj shumica ka konkluduar se pjesëmarrja në këtë Kolegj e një gjyqtari që kishte marrë pjesë më parë në një gjykim të zhvilluar në gjykatën e apelit për të njëjtën çështje, ka cenuar parimin e paanshmërisë në gjykim dhe, si pasojë, të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike. Paanshmëria kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe super partes (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 11.3.2008; nr.11, datë 2.4.2008; nr.23, datë 4.11.2008*).

Neni 6 i KEDNJ-së kërkon që një gjykatë, brenda juridiksionit të saj, të jetë e paanshme, ku paanshmëri do të thotë mungesë paragjykimi ose anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. GJEDNJ-ja ka theksuar se paanshmëria, në kuptimin e nenit 6/1 të KEDNJ-së, duhet të përcaktohet në përputhje me një test subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, në përputhje me një test objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. GJEDNJ-ja ka deklaruar vazhdimisht se në kuptim të kriterit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Përsa i përket kriterit objektiv, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie. Për rrjedhojë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që pretendojnë lidhur me mungesën e paanshmërisë së tij është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtar mbetet përcaktimi nëse dyshimi mbi paanshmërinë është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet e GJEDNJ-së, datë 31 mars 2005 në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë; datë 13 nëntor 2007 në çështjen Driza kundër Shqipërisë*).

Lidhur me paanshmërinë objektive, në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar për paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Së fundmi, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë që paragjykohet shqyrtimi përfundimtar i çështjes.

Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, rezulton nga rrethanat e çështjes se në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, ka qenë i pranishëm i njëjti gjyqtar (AM) që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së iniciuar nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në përfundim të gjyimit ka dhënë vendimin nr.318, datë 4.7.2003, vendim ky që është prishur më pas nga Gjykata e Lartë. Pra, i njëjti gjyqtar që ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe është shprehur për themelin e kësaj çështjeje, ka marrë pjesë edhe në Kolegjin që ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim. Në këto kushte kërkuesi ka ngritur para Gjykatës Kushtetuese pretendimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, që ka gjykuar duke pasur në përbërje të tij një gjyqtar që ishte shprehur më parë për të njëjtën çështje gjyqësore, ka cenuar parimin e paanshmërisë në gjykim.

Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se edhe në këtë rast paanshmëria e gjykatës duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në aspektin objektiv. Përsa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarit AM, pra bindjes së brendshme të këtij gjyqtari për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Përsa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i dyshimit të ngritur nga kërkuesi është mjaftueshëm për të provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes.

Në lidhje me këtë, gjyqtarët në pakicë vërejnë se bazuar në nenin 442 të KPC-së, mjetet për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë: ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. Rishikimi është një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës dhe, si pasojë, nëpërmjet këtij lloj gjykimi, hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë të vlefshme nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka si objekt një vendim me autoritetin e gjësë së gjykuar, bazuar në nenin 494 të KPC-së, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod; mes të tjerash, edhe kur zbulohen rrethana të reja ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj.

Mjetet e zakonshme të ankimit ushtrohen kundër shkeljes së normave procedurale ose mosrespektimit dhe zbatimit të keq të ligjit, ndërsa kërkesa për rishikim bëhet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit. Rishikimi presupozon një gjykim vlefshmërisht të mbyllur dhe që pranohet të rihapet për shkaqe që në asnjë mënyrë nuk përfshijnë veprimtarinë vlerësuese të gjyqtarit në gjykimin që kërkohet/pranohet të rishikohet.

Sa më sipër nënkupton se gjyqtari, që shqyrton kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, nuk kryen vlerësime të reja, në themel, të të njëjtave fakte të vlerësuara nga gjykata në gjykimin e themelit, por ai kryen një vlerësim, për herë të parë, të fakteve/provave të reja, të cilat nuk kanë qenë më parë objekt gjykimi, diskutimi dhe vlerësimi nga gjykata që ka dhënë vendimin për të cilin bëhet rishikimi.

Gjyqtarët në pakicë çmojnë të përmendin, për këtë qëllim, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Italisë, në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim, e cila vlerëson se kërkesa më e rëndësishme, në lidhje me çdo lloj procesi, është vetëm ajo e shmangies që i njëjti gjyqtar, në marrjen e vendimit, të duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik të ndjekur më parë, pra kusht i nevojshëm për të vlerësuar një rast papajtueshmërie është ekzistenca e vlerësimeve që bien mbi vetë *res iudicanda* (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.387/1999; nr.131/1996*). Pra, gjyqtari të mos jetë i kushtëzuar nga vlerësime të mëparshme të shprehura mbi të njëjtën *res iudicanda*, si pasojë e veprimtarisë së zhvilluar më parë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.308/1997*).

Gjyqtarët në pakicë vërejnë, gjithashtu, se bazuar në nenin 72/4 të KPC-së, një nga rastet për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi është kur ai ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim ose ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit. Kjo dispozitë kërkon ndryshimin e gjyqtarit, i cili ndodhet në situatën që, për shkak të karakterit të mjetit të apelit, i duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik që ka ndjekur tashmë në gjykimin për të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar. Në terma të tjerë, shprehja “shkallë tjetër” nuk mund të ketë një zbatim të kufizuar vetëm në shkallë të ndryshme të procesit, por duhet të përfshijë, në një interpretim konform me Kushtetutën, edhe fazën që brenda një procesi civil ka karakter autonom, me përmbajtje detyruese, që karakterizohet (për veçantinë e gjykimit për të cilin diskutohet) nga një vendim që i përket të njëjtit objekt dhe të njëjtave vlerësime vendimtare mbi themelin e çështjes (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr.387/1999*).

Do të ishim para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt në rast se do të rezultonte e kompromentuar paanshmëria e gjyqtarit, qoftë në rastin kur gjyqtari ka manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim, qoftë kur vlerësimi i themelit është shprehur në një procedim të ndryshëm, por në çdo rast efektet cenuese duhet të vërtetohen *in concreto*.

Rezulton se kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi për anulimin e vendimeve të KKKP-së qarku Berat që kanë njohur pronësinë dhe kthyer pronën shtetasve Lefta. Objekt i shqyrtimit gjyqësor, pra i themelit të çështjes, në të gjitha shkallët, pra dhe në Gjykatën e Apelit që ka dhënë vendimin nr.318, datë 04.07.2003 dhe ku ka marrë pjesë gjyqtari AM, kanë qenë vendimet e KKKP-së qarku Berat, kontratat me të cilat kërkuesi ka blerë sipërfaqen e truallit nga Seksioni i financës i rrethit Berat, vërtetimet e pronësisë të palës së paditur, të mbështetura në të dhëna arkivore dhe regjistrin hipotekor, si dhe aktet e ekspertimit të urdhëruara nga gjykatat, mbi bazën e të cilave gjykata ka konkluduar se prona objekt konflikti mes palëve i përket vëllazërisë Lefta dhe se kërkuesi ka zgjeruar ndërtimin në mënyrë të paligjshme mbi këtë pronë. Ndërsa trupi gjykues që ka marrë në shqyrtim, në dhomë këshillimi, kërkesën për rishikim, ka vlerësuar vetëm faktin nëse gjendet para njërit nga rastet për të cilat mund të ushtrohet ky mjet ankimi dhe nëse dokumentet e paraqitura nga kërkuesi përbëjnë prova të reja që kanë rëndësi për çështjen, në kuptim të nenit 494 të KPC-së.

Siç u theksua më sipër, Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit verifikon fillimisht rastet e rishikimit, legjitimitetin e kërkuetit, bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesës për rishikimin e vendimit, si dhe praninë e kriterëve ligjore për shqyrtimin e saj dhe, kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 të këtij Kodi, ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezultojnë haptazi e pambështetur, vendos mospranimin e saj. Shtrirja, objekti dhe natyra e gjyqimit në gjykatën e apelit (në rastin konkret) dallon në mënyrë të qartë nga gjykimi që bëhet gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim. Në rastin në shqyrtim, bazuar në rrethanat konkrete, vlerësimi që i është bërë në dhomë këshillimi provave të paraqitura nga kërkueti për të mbështetur kërkesën e tij për rishikim është i ndryshëm nga vlerësimi që ka bërë gjyqtari për të vendosur lidhur me konfliktin objekt i këtij gjykimi. Pra, nuk rezultojnë që atij t'i jetë dashur që, për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për kërkesën për rishikim, të përshkojë të njëjtin itinerar logjik të ndjekur më parë në gjykimin si gjyqtar apeli, pra të japë mendim mbi të njëjtin objekt dhe të njëjtat vlerësime që ka dhënë më parë mbi themelin e çështjes. Fakti se gjyqtari AM ka patur më parë njohje të fakteve të çështjes, ka marrë prova, si dhe është shprehur mbi themelin e kësaj çështjeje, nga pikëpamja e testit objektiv, nuk përbën shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e tij në gjykimin e kërkesës për rishikim.

Duke pasur parasysh sa më sipër, gjyqtarët në pakicë nuk vërejnë që veprimet e gjyqtarit AM të kenë minuar garancinë e paanshmërisë në gjykim. Vetëm fakti se ky gjyqtar ka marrë pjesë në gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se kjo Gjykatë ka cenuar parimin e paanshmërisë në gjykim dhe për pasojë të drejtën e kërkuetit për një proces të rregullt ligjor.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Petrit Plloçi, Vladimir Kristo

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 21.3.2011
Doli nga shtypi më 23.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 20 lekë